



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

Nr. 212/1 Prot.

Shkodër, më 31/03 / 2026

VENDIM

Nr. 03, Datë 27.03.2026

“PËR DISA NDRYSHIME NË VKQSHKODËR NR.26, DATË 23.12.2025 -PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, KATEGORITË/KLASAT PËR ÇDO POZICION, PAGAT DHE NUMRIN E PUNONJËSVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILË E TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIV TË ADMINISTRATË SË SË KËSHILLIT TË QARKUT SHKODËR PËR VITIN 2026, STRUKTURA ORGANIZATIVE E DAMT PËR VITIN 2026 SI DHE MIRATIMIN E SHPERBLIMIT MUJOR TË ANËTARËVE TË KRYESISË SË KËSHILLIT TË QARKUT SHKODËR PËR VITIN 2026.”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e Datës 27.03.2026, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi shqyrtoi materialin e përgatitur nga zyrtarët e administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër “Për disa ndryshime në VKQShkodër nr. 26, datë 23.12.2025 - për miratimin e strukturës organizative, kategoritë/klasat për çdo pozicion, pagat dhe numrin e punonjësve të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të Administratë së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2026, struktura organizave e DAMT-së për vitin 2026 si dhe miratimin e shpërblimit mujor të anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2026”, bazuar në: Ligjin Nr.139/2015, Datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, përkatësisht në Nenin 8, pika 2) dhe Nenin 77, gërma ç); Ligjin Nr. 152/2013 ‘Për Nëpunësin Civil’ (i ndryshuar); nenin 15 të Ligjit nr.87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026” Vendimin Nr.103, datë 11.02.2026 “ Për disa ndryshime në VKM-në Nr.328 Datë 31.05.2023 ”Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, Ligjin nr. 35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vëndi”, Bazuar

edhe ne Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas
relatimit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e
këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **14 Vota Pro, 0 Vota Kunder** dhe **0 Vota**
Abstenim,

VENDOSI:

1. Pika 1 e VKQShkodër nr.26, datë 23.12.2025-Të miratojë Strukturën Organizative, kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion, pagat dhe numrin e punonjësve, të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2026, me gjithsejt 16 (gjashtë mbëdhjetë) punonjës, 3 (tre) të zgjedhur dhe 13(Trembëdhjetë) punonjës administrativ, do të jetë sipas tabelës bashkangjitur, të ndryshuar.
2. Pika 5 e VKQShkodër nr.26, datë 23.12.2025- Të miratojë shpërblimin mujor të Anëtarëve të kryesisë së KQSH për vitin 2026, do jetë në masën 10% të pagës së Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, sipas pagës së re.
3. Efektet financiare për zbatimin e vendimit të mësipërm do fillojnë nga data 01.01.2026.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

KRYETARI
Edmond NDOU

